

OJQ “NEVO KONCEPTI - NVK”

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

DHE

PASQYRAT FINANCIARE

Për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019

Audit BB Sh.p.k.

10 Gusht 2019

PËRMBAJTJA

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	2
PASQYRAT FINANCIARE	4
PASQYRA E TË ARDHURAVE	4
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR – BILANCI I GJENDJES	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË FONDE.....	6
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË.....	6
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	7
1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME	7
2. POLITIKAT KONTABËL.....	9
3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT.....	9

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për: Bordit të drejtorëve të OJQ "NEVO KONCEPTI - NVK" - Prizren

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të OJQ "NEVO KONCEPTI", të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar me datën 31 Dhjetor 2019, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në fonde dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas mendimit tonë pasqyrat financiare të OJQ "NEVO KONCEPTI" prezantojnë në mënyrë të drejtë dhe të sinqertë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të OJQ-së, performancën financiare si dhe rrjedhën e parasë për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019 në përputhje me bazat e përpilimit të raportimit financiar të përshkruara në paragrafin 2.1 të këtij raporti.

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet e Raportimit Financiar të zbatueshme në Kosovë, dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpres aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare. Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidencë auditimi që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformatuara, anashkalime të kontrolleve të brendshme.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga drejtimi.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Shoqërisë për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e audituesit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Shoqëria të ndërpresë veprimtarinë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Audit BB Sh.p.k

Bahitjar Berisha, Auditor Ligjor

10 Gusht 2020



PASQYRAT FINANCIARE

PASQYRA E TË ARDHURAVE

OJQ "NEVO KONCEPTI"			
Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse për periudhën 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2019			
Të ardhurat	Shënim	2019	2018
		Euro	Euro
Të hyrat nga grantet dhe donacionet		334,275	335,927
Të hyrat nga aktivitetet		-	-
Të hyrat tjera		230	-
	Gjithsej te ardhurat	334,504	335,927
Shpenzimet			
Shpenzimet programore			
Pagat dhe mëditjet bruto		90,709	202,022
Shpenzimet programore		114,497	110,707
	Gjithsej shpenzimet programore	205,206	312,729
Menaxhment dhe administratë			
Pagat dhe mëditjet bruto		139,122	41,760
Shpenzimet operative		12,000	19,570
Të tjera		104	8,687
	Gjithsej shpenzimet menaxhment dhe administratë	151,226	70,017
Shpenzimet tjera (zhvlerësimi i pajisjeve)	6	3,593	4,867
	Gjithsej shpenzimet tjera	3,593	4,867
	Gjithsej shpenzimet	360,025	387,613
Net rritje / pakësim nga operacionet		(25,521)	(51,686)
Shpenzimet e tatimit në fitim		-	-
Net rritje / pakësim i fondeve të periudhës		(25,521)	(51,686)
Net rritje / pakësim i fondeve nga periudhat e kaluara		37,065	88,751
Fondet e mbajtura në fund të vitit (të hyrat e shtyra)	9	11,544	37,065

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR – BILANCI I GJENDJES

OJQ "NEVO KONCEPTI"			
Pasqyra e pozitës financiare - Bilanci i gjendjes për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019			
PASURITË	Shënim	2019	2018
		Euro	Euro
Pasuritë afatshkurtëra			
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	4	23,854	23,555
Parapagimet	5	-	13,846
Gjithsej pasuritë afatshkurtëra		23,854	37,401
Pasuritë afatgjata			
Prona, pajisjet dhe impiantet	6	3,593	7,187
Gjithsej pasuritë afatgjata		3,593	7,187
GJITHSEJ PASURITË		27,448	44,587
FONDET DHE DETYRIMET			
Detyrimet afatshkurta			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe te tjera	7	4,625	336
Detyrime ndaj pagave, TAP dhe KP	8	8,467	-
Gjithsej detyrimet afatshkurta		13,092	336
Detyrimet afatgjata			
Detyrimet ndaj pasurisë afatgjate	6	3,593	7,187
Gjithsej detyrimet afatgjata		3,593	7,187
GJITHSEJ DETYRIMET		16,686	7,523
FONDET			
Net rritje/pakësim të fondeve nga periudhat e kaluara		37,065	88,751
Net rritje/pakësim të fondeve nga periudha vijuese		(25,521)	(51,686)
Kthim i fondeve donatorëve		(782)	-
Gjithsej fondi		10,762	37,065
GJITHSEJ FONDET DHE DETYRIMET		27,448	44,587

Këto pasqyra financiare janë përgatitur, aprovuar dhe nënshkruar nga menaxhmenti i OJQ-së

Përgatitur nga: Tasim Shasivari
(Emri, mbiemri dhe nënshkrimi)

Datë: 11.08.2020

Aprovuar nga: Osman Osmani
(Emri, mbiemri dhe nënshkrimi)

Datë: 11.08.2020

**NEVO
KONCEPTI**

PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË FONDE

OJQ "NEVO KONCEPTI"				
Pasqyra e ndryshimeve në fonde për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019				
	Fondet fillestare	Fondet e akumuluar	Rezervat e tjera	Gjithsej
	Euro	Euro	Euro	Euro
Gjendja më 1 Janar 2018	-	88,751	-	88,751
Net rritje / pakës im nga operacionet		(51,686)		(51,686)
Gjendja më 31 Dhjetor 2018	-	37,065	-	37,065
Net rritje / pakës im nga operacionet		(25,521)		(25,521)
Kthim i fondeve		(782)		(782)
Gjendja më 31 Dhjetor 2019	-	10,762	-	10,762

PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË

OJQ "NEVO KONCEPTI"			
Pasqyra e rrjedhës së keshit (parasë) për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019			
	Shënim	2019	2018
		Euro	Euro
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Fitimi / (humbja) i / e vitit		(25,521)	(51,686)
Rregullimet për zërat jo në para të shpenzimeve dhe të hyrave			
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	6	3,593	4,867
		3,593	4,867
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative			
(Rritja) / zvogëlimi në parapagime	5	13,846	24,139
Rritja / (zvogëlimi) në logaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	7	4,289	136
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet ndaj pagave TMB dhe KP	8	8,467	(2,901)
Rritja / (zvogëlimi) në detyrimet ndaj pasurisë afatgjate	6	(3,593)	(3,593)
		23,009	17,781
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative		1,081	(29,038)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	6	-	(1,274)
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese		-	(1,274)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Fondet e kthyera		(782)	-
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese		(782)	-
Rrjedha neto e parasë		299	(30,312)
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	4	23,555	53,867
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit		23,854	23,555

SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

OJQ "NEVO KONCEPTI" apo shkurtimisht "NVK" është themeluar sipas Ligji Nr. 06/L-43, Neni 15 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

- Organizata quhet "NEVO KONCEPTI"
- Ajo njihet edhe si OJQ "NVK"
- Organizata është shoqatë jofitimprurëse, sipas definimit të dhënë në nenin 12 të Ligjit Nr. 06/L-43 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare në Republikën e Kosovës.

Data e regjistrimit: 26 Nëntor 2014
NRB: 5115293-0
NRF: 601188700
NRSB: N/A
NR TVSH: N/A
Lloji i shoqërisë: Organizatë Jo Qeveritare
Adresa e regjistrimit: Rr. Adnan Krasniqi – 149/II/8, Prizren
Themeluesit: **Erxhan Galushi**, Rr. Haxhi Zeka Nr.47 në Prizren dhe me Nr. Personal: 1173002579
Edon Korllari, Rr. Xheladin Hana Nr. 48 në Prizren dhe me Nr. Personal: 1234654574
Nurgjan Qorri, Rr.Takova Nr. 7 në Prizren dhe me Nr. Personal: 1170796701
Kryesues i bordit të OJQ: **Daut Qylanxhi**
Përfaqësues i OJQ-së: **Osman Osmani**, Drejtor Ekzekutiv

Veprimtaria, qëllimi dhe misioni i themelimit

OJQ "NEVO KONCEPTI" është themeluar me qëllim të:

Përmirësimit të gjendjes së komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian në fushën e arsimit dhe në fushat tjera të cilat ndikojnë në mirëqenien e tyre përmes aktiviteteve për ngritjen e vetëdijes së komunitetit, fuqizimit të kapaciteteve dhe avokimit, me prioritet integrimin e fëmijëve të komuniteteve në fjalë në procesin mësimor.

Aktiviteti i OJQ-së përgjatë vitit 2019 ka qenë i fokusuar në zhvillimin e projekteve si në vijim:

- **Risocializimi i të rikthyerve Romë, Ashkali dhe Egjiptian nga Evropa Perëndimore në Komunën e Prizrenit (REACH II)**, i financuar nga Qeveria Gjermane dhe Fondacioni Gjerman Karl Kübel Stiftung für Kind und Familie (KKS).
- **Promovimi i integritit dinjitoz të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Pejë dhe Suharekë (Prospekt+)**, i financuar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri të Hapur (KFOS) me mbështetjen e Qeverisë Gjermane dhe Fondacionit Gjerman Karl Kübel Stiftung für Kind und Familie (KKS).
- **Përkrahja e BE-së për zbatimin e Strategjisë për Romë, Ashkali dhe Egjiptian, Faza 2 Edukimi për Integrit (EU SIMRAES 2)**, i financuar nga Qendra për Edukim e Kosovës (KEC) me mbështetjen e Bashkimit Evropian (BE).
- **Mbështetje për edukimin e rregullt të fëmijëve të riatdhesuar dhe komunitetit pakicë në komunat e Prizrenit dhe Gjakovës, Kosovë (CDBE)**, të financuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit - GIZ.
- **Fuqizimi i të drejtave sociale të grupeve të marginalizuara në Komunën e Prizrenit (SoRi)**, të financuar nga Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit - GIZ.
- **Qeverisja e të drejtave të fëmijëve (SIDA)**, financuar nga Save the Children International në Kosovë.

2. POLITIKAT KONTABËL

2.1 Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me standardet e kontabilitetit dhe raportimit financiar të zbatueshme në Republikën e Kosovës dhe në pajtueshmëri me Ligjin Nr. 06/L-43 që aktualisht janë në fuqi në Republikën e Kosovës si dhe mbi bazën e kontabilitetit të përcaktuar në marrëveshjen me donatorët duke përfshi ketu edhe buxhetimin.

2.2 Bazat e matjes

Pasqyrat Financiare përgatiten në bazë të kostos historike dhe bazës së moderuar të koshit, ku të ardhurat njihen kur ato inkasohen e jo kur ato fitohen, ndërsa shpenzimet njihen kur ato paguhen e jo kur ato ndodhin, modifikimi i bazës së keshit bëhet vetëm për shpenzimet e grumbulluara në fund të periudhës së raportimit vjetor.

2.3 Valuta raportuese dhe prezantimi

Pasqyrat financiare janë përgatitur dhe prezantuar në valutën EURO, e cila njëherit është valuta funksionale dhe legale në Republikën e Kosovës.

2.4 Sistemi i kontabilitetit

Organizata përdor sistemin e kontabilitetit të zhvilluar në "LOG MICRO", i cili prodhon raporte të mjaftueshme financiare siç janë; libri i arkës, libri i bankës, librin kryesor, raportet e të hyrave dhe shpenzimeve për projekte si dhe pasqyrat financiare të OJQ-së si tërësi.

2.5 Vijimësia

Pasqyra e pozicionit financiar dhe pasqyra e të ardhurave janë përgatitur mbi bazën e vijimësisë, sipas së cilës shoqëria do të jetë në gjendje të realizojë pasuritë dhe detyrimet e saja në rrjedhën normale të biznesit.

3. POLITIKAT E RËNDËSISHME TË KONTABILITETIT

3.1 Prona, Impiantet dhe pajisjet

Njohja dhe matja

Prona, impiantet dhe pajisjet janë matur në bazë të kostos historike duke zbritur zhvlerësimin e akumuluar dhe çdo humbje të akumuluar nga dëmtimi (rënia në vlerë). Kostoja e blerjes përfshin shpenzimet që janë drejtëpërdrejtë të lidhura me blerjen e pasurive. Kostoja e pasurive të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve, punës direkte dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtëpërdrejt me sjelljen e pasurisë në gjendje funksionale për destinimin e saj.

Kostot pasuese – të zëvendësimit

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të pronës, impianteve dhe pajisjeve është njohur në vlerën bartëse të saj nëse është e mundur që benefitet e ardhshme ekonomike të trupëzuara përbrenda pjesës do të rrjedhin në shoqëri dhe kostoja e saj mund të matet me besueshmëri. Kostot e mirëmbajtjes së pronës, impianteve dhe pajisjeve ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur.

Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet mbi një bazë reduktimi gjatë jetës së dobishme të vlerësuar të mjeteve. Zhvlerësimi është përlogaritur me metodën lineare përgjatë jetës së përdorimit të tyre.

Normat e përdorura vjetore të zhvlerësimit janë:

- Objektet ndërtimore 5%
- Pajisjet dhe makinëritë 10%
- Mjetet transportuese 20%

3.2 Instrumentet financiare

Shoqëria mbanë vetëm instrumente financiare jo-derivative, të përbëra nga paraja dhe ekuivalentët e parasë, të arkëtueshmet tregtare, kreditë dhe huamarrjet, të pagueshmet tregtare dhe të pagueshmet tjera.

Paraja dhe ekuivalentët e parasë

Paraja dhe ekuivalentët e parasë përfshijnë paranë në arkë dhe depozitat rrjedhëse të mbajtura në bankat vendore.

Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera maten me vlerën e drejtë dhe janë kërkesa të dala nga veprimtaria e regullt dhe që pritet të inkasohen nga debitorët. Në fund të çdo periudhe raportuese, vlerat kontabël të llogarive të arkëtueshme tregtare dhe të tjera shqyrtohen për të përcaktuar nëse ka ndonjë evidencë objektive që shumat nuk janë të rikuperueshme dhe një humbje nga dëmtimi (rënia në vlerë) njihet menjëherë në pasqyrën e të ardhurave.

Të pagueshmet tregtare dhe të tjera

Të pagueshmet tregtare dhe të tjera njihen me vlerën e tyre të drejtë dhe janë detyrime të dala nga afarizmi i regullt në bazë të afateve normale të kreditimit dhe nuk bartin interes.

3.3 Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme të sigurimeve sociale

OJQ-ja kontribuon vetëm me kontribute për sigurime sociale të detyrueshme që përcaktojnë përfitime pensionale për punëtorët pas pensionimit. Qeveria e Kosovës është kompetente për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Kosovë sipas një plani kontributësh pensionale të përcaktuar. Kontributet e kompanisë për planin e pensioneve janë të ngarkuar në fitim ose humbje kur kanë ndodhur.

3.4 Të ardhurat dhe shpenzimet

Të Ardhurat nga grantet dhe donacionet

Të ardhurat nga grantet dhe donacionet njihen si e hyrë në momentin e inkasimit të tyre, duke e ndarë mëpastaj atë, në të hyrat e periudhës raportuese dhe të hyrat e shtyra që i takojnë periudhave të ardhshme raportuese. Të hyrat nga aktivitete ekonomike njihen kur mallrat janë dorëzuar dhe pronësia është bartur si dhe shërbimet janë kryer.

Shpenzimet operative

Shpenzimet e direkte programore dhe shpenzimet tjera indirekte njihen në bazë akruale që d.m.th atëherë kur ato ndodhin.

3.5 Tatimi mbi të ardhurat

Shoqëria është organizatë jo profitabile dhe nuk shpërndanë fitim, kështu që sipas legjislacionit në fuqi nuk është subjekt i tatimit në të ardhura.

3.6 Përcaktimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë e parasë dhe ekuivalentëve të sajë, llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme janë përafërsisht të barabartë me vlerën e tyre, për shkak të likuiditetit dhe maturimit afatshkurtër të tyre.

4. PARAJA DHE EKUIVALENTËT E PARASË

Paraja dhe ekuivalentët e parasë pasqyrojnë paranë në bankë dhe arkë, më 31 Dhjetor 2019 përbëhet nga si më poshtë:

Paraja dhe ekuivalentët e parasë	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
ARKA SoRi	-	2.50
ARKA CDBE	84.22	4.22
Gjithsej paraja e imët	84.22	6.72
BANKA Prospekt +	307.59	13.36
BANKA EUSIMRAES II	2,782.47	4,815.49
BANKA REACH II	19,616.06	1,410.76
BANKA SIDA	1,061.24	1,671.21
BANKA SoRi	-	1,306.52
BANKA CDBE	2.60	13,454.37
BANKA NEVO	-	842.04
BANKA OPIC	-	34.39
Gjithsej paraja në bankë	23,769.96	23,548.14
Gjithsej paraja	23,854.18	23,554.86

5. PARAPAGIMET

Parapagimet prezantojnë pagesat paradhënje për shpenzimet programore dhe ato operative dhe që do të njihen si shpenzim në periudhat vijuese të raportimit, më datë 31 Dhjetor 2019 përbëhen si më poshtë:

Parapagimet	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Office 1 Kosova shpk	-	8,303.82
Durmis Aslano	-	2,550.00
Radio Televizioni Besa	-	750.00
Creativ	-	1,920.00
Telekomi i Kosoves	-	72.05
Shkumbin Asllani	-	250.00
Gjithsej	-	13,845.87

6. PASURITË AFATGJATA

Pasuritë afatgjate materiale prezantojnë pajisjet të cilat OJQ-ja i ka në shfrytëzim dhe që donatorëve i janë raportuar si shpenzim, nuk ka një marrëveshje mbi bartjen e pronësisë së tyre OJQ-së, më 31 Dhjetor 2019 përbëhen nga si më poshtë:

Prona, pajisjet dhe impiantet	Toka	Objektet ndërtimore	Makineritë dhe pajisjet	Gjithsej
Kosto historike	-	-	31,305.07	31,305.07
Zhvierësimi i akumuluar	-	-	24,118.40	24,118.40
Zhvierësimi për vitin raportues	-	-	3,593.33	3,593.33
Më 31 Dhjetor 2019	-	-	27,711.74	27,711.74
Vlera NETO	-	-	3,593.33	3,593.33
Investimet / Kapitalizimet/	-	-	-	-
Vlera NETO më 31 Dhjetor 2019	-	-	3,593.33	3,593.33
Kosto historike	-	-	30,030.97	30,030.97
Zhvierësimi i akumuluar	-	-	19,250.97	19,250.97
Zhvierësimi për vitin raportues	-	-	4,867.43	4,867.43
Më 31 Dhjetor 2018	-	-	24,118.40	24,118.40
Vlera NETO	-	-	5,912.57	5,912.57
Investimet / Kapitalizimet/	-	-	1,274.10	1,274.10
Vlera NETO më 31 Dhjetor 2018	-	-	7,186.67	7,186.67

7. LLOGARITË E PAGUESHME TREGËTARE DHE TË TJERA

Llogaritë e pagueshme prezantojnë detyrimet afatshkurta të dala nga operacionet si dhe të pagueshme të tjera më 31 Dhjetor 2019 përbëhen nga si më poshtë:

Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Llogaritë e pagueshme	4,554.89	336.16
Huazime interne (nga punëtorët)	70.00	-

8. DETYRIME PËR TAP, TMB dhe KONTRIBUTEVE PENSIONALE

Më 31 Dhjetor 2019 prezantojnë detyrimet afatshkurtëra për të ardhurat personale, tatimi në TAP i mbajtur në burim dhe kontributet pensionale që përbëhen nga si më poshtë:

Detyrime TAP, TMB, KP	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Pagat neto	5,606.08	-
Tatimi në paga	1,109.77	-
Kontributi pensional 5%	875.74	-
Kontributi pensional 5%	875.74	-
Gjithsej	8,467.33	-

9. FONDET

Më 31 Dhjetor 2018 prezantojnë fondet e bartura, fondet e kthyer dhe rritjen apo pakësimin e fondeve të periudhës dhe përbëhen nga si më poshtë:

Fondet	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Net rritje/pakësim të fondeve nga periudhat e kaluara	63,229.81	88,750.77
Net rritje/pakësim të fondeve nga periudha vijuese	(25,520.96)	(25,520.96)
Kthim donatorëve	(781.65)	-
Gjithsej fondet e bartura	36,927.20	63,229.81

10. TË ARDHURAT

Të ardhurat prezantojnë të hyrat e inkasuara nga grantet, donacionet, antarësia dhe aktivitet ekonomike dhe më datë 31 Dhjetor 2019 përbëhen si më poshtë:

Të ardhurat	1 Janar - 31 Dhjetor 2019	1 Janar - 31 Dhjetor 2018
Prospekt +	30,070.00	23,272.00
EUSIMRAES II	12,909.26	39,235.52
REACH II	130,328.00	58,650.00
SIDA	50,762.37	49,326.12
SoRi	33,095.00	37,901.80
CDBE	77,110.00	79,715.00
IKEA	-	4,990.25
MEDICOR Foundation	-	19,439.24
CDBE kthim i TVSH	-	4,125.38
OPIC	-	19,271.95
Të hyrat nga donacionet	334,274.63	335,927.26
Të hyrat nga aktivitetet	-	-
Të hyra tjera (donacione private/bamirësi etj.)	229.50	-
Të hyrat tjera	229.50	-
Gjithsej	334,504.13	335,927.26

10.1 Të ardhurat e shytyra (të pafituara)

Të ardhurat e shytyra prezantojnë të hyrat nga grantet dhe donacionet që janë inkasuar por që i takojnë periudhave vijuese të raportimit, më datë 31 Dhjetor 2019 përbëhen si më poshtë:

Të ardhurat e shytyra	31 Dhjetor 2019	31 Dhjetor 2018
Të hyrat e shytyra (REACH II)	9,393.13	1,410.76
Të hyrat e shytyra (SIDA)	1,061.24	1,646.22
Të hyrat e shytyra (Prospekt +)	307.59	-
Të hyrat e shytyra (CDBE)	-	27,094.02
Të hyrat e shytyra (SoRi)	-	1,358.84
Të hyrat e shytyra (NEVO)	-	837.36
Të hyrat e shytyra (EUSIMRAES II)	-	4,683.12
Të hyrat e shytyra (OPIC)	-	34.39
Gjithsej	10,761.96	37,064.71

11. SHPENZIMET PROGRAMORE

Shpenzimet programore prezantojnë shpenzimet direkte për zhvillimin dhe mbarrëvajtjen e projekteve përgjatë periudhës 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2019, të cilat përbëhen nga si më poshtë:

	1 Janar - 31 Dhjetor 2019	1 Janar - 31 Dhjetor 2018
Shpenzimet programore		
Pagat dhe mëditjet bruto	90,708.69	202,022.48
Shpenzimet programore	114,496.82	110,706.53
Shpenzimet tjera	-	-
Gjithsej	205,205.51	312,729.01

12. SHPENZIMET E ADMINISTRATËS DHE MENAXHMENTIT

Shpenzimet e administrates dhe menaxhmentit prezantojnë shpenzimet indirekte në mbështetje të mbarrëvajtjes së projekteve të zhvilluara nga organizata përgjatë periudhës 1 Janar deri më 31 Dhjetor 2018, që përbëhen nga si më poshtë:

	1 Janar - 31 Dhjetor 2019	1 Janar - 31 Dhjetor 2018
Shpenzimet administrates dhe menaxhmentit		
Pagat dhe mëditjet bruto	139,122.23	41,759.66
Shpenzimet operative	12,000.00	19,570.08
Shpenzimet tjera	104.02	8,687.28
Gjithsej	151,226.25	70,017.02

13. NGJARJET PAS DATËS

Menaxhmenti është përgjegjës për shpalosjen e ngjarjeve të mëvonshme pas datës së përpilimit të pasqyrave financiare që kërkojnë rregullime ose shpalosje në pasqyrat financiare, ne gjatë auditimit nuk kemi konstatuar ngjarje pas datës së përpilimit të pasqyrave financiare. Menaxhmenti gjithashtu është përgjegjës për shpalosjen e ngjarjeve të mëvonshme pas datës së përpilimit të pasqyrave financiare por që nuk kërkojnë rregullime të pasqyrave financiare.

Gjatë auditimit, ne jemi ballafaquar me pandeminë globale COVID-19 e cila është një ngjarje që mundë të ketë ndikim në rezultatet e projekteve në të ardhmen. Meqenëse kohëzgjatja dhe ndikimi i pandemisë Covid-19 janë të panjohura si dhe masat ekonomike të paqarta, nuk është e mundur të vlerësohet me besueshmëri efekti dhe ndikimi i sajë në pozicionin financiar dhe rezultatet e shoqërisë për periudhat e ardhshme.